



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT

N J O F T I M

PËR PROVIMIN E DIGJITALIZUAR PËR PUNËSIMIN SI TEKNIK I SHKENCAVE

MJEKËSORE

Ju bëjmë me dije se duke nisur nga data **19 Tetor 2020**, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), me adresë: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 23, Tiranë (ish-ATSH), do të zhvillohet provimi i digjitalizuar për punësimin si teknik i shkencave mjekësore.

Në vijim do të publikohet kalendari me datat dhe oraret përkatëse për kandidatët e regjistruar.

Në kuadër të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19 dhe në vijim të masave parandaluese të përhapjes së tij, nëpërmjet urdhrave të publikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, provimet do të zhvillohen duke zbatuar me përpikmëri rregullat e mëposhtme:

Qendra e Shërbimeve Arsimore është përgjegjëse për ofrimin e sigurisë maksimale dhe kushteve të përshtatshme higjieno - sanitare, duke ofruar:

- *pastrim dhe dezinfektim të ambienteve të provimit me solucione dezinfektuese të miratuara, përpara dhe pas çdo seance provimi;*
- *pastrim dhe dezinfektim të pajisjeve fizike të ambienteve të provimit, si: kompjuterët, pajisjet elektronike, karriket, tavolinat, etj;*
- *vendosje të solucioneve dezinfektuese në hyrje të çdo ambienti provimi;*
- *respektim të distancës 1,5 – 2 metër ndërmjet kandidatëve gjatë gjithë proceseve të zhvillimit të provimit;*
- *mundësinë e kryerjes së provimit në kabina të veçanta për secilin kandidat, duke respektuar distancën fizike nga njëri – tjetri;*
- *pajisjen me mjetet e duhura mbrojtëse si maska dhe doreza plastike, të stafit të institucionit dhe personave të jashtëm, të përfshirë në proceset e zhvillimit të provimit.*

Gjatë paraqitjes për pjesëmarrje në provim, kandidati duhet të ketë parasysht dhe të zbatojë rregullat e mëposhtme:

1. *të paraqitet pranë QSHA-së, i pajisur me mjetet mbrojtëse, maskë dhe doreza plastike;*
2. *të zbatojë ruajtjen e distancës fizike 1,5 – 2 metër nga kandidatët e tjerë.;*
3. *të ketë me vete vetëm dokumentet e kërkuara dhe mjetin e identifikimit;*
4. *të ketë me vete stilolaps për nënshkrimin e deklaratës dhe rezultatit të provimit;*
5. *të mos ketë me vete celularë, çanta dhe sende të tjera personale të panevojshme për zhvillimin e provimit.*

Kandidati duhet të paraqitet pranë QSHA-së **30 minuta para fillimit** provimit dhe duhet të jetë i pajisur me:

1. Letërnjoftim (Kartë ID ose Pasaportë, dokumenti origjinal);
 2. Kopje të Kartës ID ose Pasaportës;
 3. Faturën e pagesës (me vulën e bankës përkatëse) së tarifës për QSHA-në.
- Formularin për kryerjen e pagesës mund ta shkarkoni në linkun më poshtë:

http://qsha.gov.al/DPSH/materiale/fatura/fature_punesim_shkenca_teknike.pdf

Kandidatëve të cilëve u mungojnë këto dokumente, nuk do të mund të marrin pjesë në provim.

Për paraqitjen në mjediset e provimit, kandidati duhet të ketë parasysh rregullat e mëposhtme:

1. ndalohet **marrja me vete** dhe **përdorimi i celularëve** dhe mjeteve të tjera të komunikimit, pasi ky vlerësohet si kriter s' kualifikimi;
2. ndalohet komunikimi gjatë zhvillimit të provimit;
3. ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e provimit;

Për të gjithë kandidatët, lutemi të verifikoni identitetin dhe orarin e provimit në faqen zyrtare të QSHA-së, në adresën www.qsha.gov.al, “Provimet e Shtetit”, rubrika “Njoftime”, lista e kandidatëve për provimin e digjitalizuar për punësimin si teknik i shkencave mjekësore.

Ju urojmë suksese!